

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Emine Kaçiku, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses P. Sh.A. të cilën me autorizim e përfaqëson av.D. P., nga P., kundër vendimit e të paditurës – Komuna e Mitrovicës, nr.... dt...., në çështjen administrative-anulim vendimi me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ, duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.283/2018 dt.21.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 05.06.2018, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZHET si e pabazuar kërkesa e paditëses P. Sh.A, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.283/2018 të datës 21.05.2018.

Arsyetim

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.283/2018 të datës 21.05.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses P. Sh.A, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative A.U.nr.900/2018 dt.27.04.2018, me të cilin është refuzuar si i pabazuar propozimi i paditëses për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e të paditurës Komuna e Mitrovicës, nr..... dt....., derisa të merret vendim sipas padisë së paditëses.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.283/2018 dt.21.05.2018, paditësja ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të së drejtës procedurale, me propozim që të aprovohet kërkesa dhe të ndrushohen aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative A.U.nr.900/2018 dt.27.04.2018 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.283/2018 dt.21.05.2018, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kontestuar, kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.283/2018 dt.21.05.2018 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses P. Sh.A, ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departmaneti për Çështje Administrative, A.U.nr.900/2018 dt.27.04.2018, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditëses për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e të paditurës Komuna e Mitrovicës nr.... dt....., derisa të merret vendim sipas padisë së paditëses.

Neni 22.2 i Ligjit për Konfliktet Administrative parasheh se shtyrja mund të bëhet me kërkesën e paditësit, organi,akti i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Ndërsa me dispoziten e nenit 22.6 të të njëjtit ligj parashihet se paditësi mund të kërkoj nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor , sipas kushteve të paraparë në nenin 22 par.2 të LKA-së .

Gjykata Supreme e Kosovës, duke e shqyrtuar kërkesën e paditësit gjen se gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejt, duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses, dhe duke e vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë A.U.nr.900/2018 dt.27.04.2018, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e të paditurës-Komuna e Mitrovicës nr..... dt....., derisa të merret vendim sipas padisë së paditëses.

Pra, në këtë rast, paditësja me ankesën e ushtruar nuk ka bërë të besueshëm me asnjë provë të vetme faktin se shtyrja e ekzekutimit, nuk është në kundërshtim me interesin publik. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 22 të LKA-së. Për këto arsye, kjo Gjykatë vendosi ta refuzoj kërkesën e paditëses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr.283/2018 dt.21.05.2018.

Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të plotë dhe të drejt ka zbatuar dispozitat e Ligjit, dispozitat e procedurës administrative, ato të Ligjit për Konfliktet Administrative. Janë të pabazuara thëniet e paditëses lidhur me shkeljet, ngase vendimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm. Arsyetimi i aktvendimit të kontestuar përmbanë arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se është bërë aplikimi i drejt të drejtës materiale dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditëses.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54.1, lidhur me nenin 22.2 dhe 6 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

ARJ-UZVP nr.42/2018 dt. 05.06.2018.

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,

Nebojsa Boriçiq

Përktheu: F. A.